



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale,
legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë**

22 Shtator 2018

Seksioni 1

**Pyetje me alternativa (1 pikësecila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

1. Cila prej alternativave të mëposhtme përbën shkak pavlefshmërie në themelim të një shoqërie tregtare:

- a) Mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e një apo e të gjithë themeluesve të shoqërisë;
- b) Mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë;
- c) Objekti i veprimtarisë nuk është në kundërshtim me ligjin;
- d) Objekti i shoqërisë nuk përcaktohet specifikisht në dispozitat e statutit nën zërin "Objekti".

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

2. Afati i emërimit të administratorit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të jetë më i gjatë se:

- a) 3 vjet;
- b) 5 vjet;
- c) 7 vjet;
- d) 9 vjet.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

3. Sipas rregullave për emërtimin e subjekteve mund:

- a) Të regjistrohen subjekte me emra të njëjtë;
- b) Të regjistrohen subjekteve me emra të ngjashëm;

- c) Të dyja alternativat janë të sakta;
- d) Asnjë prej alternative nuk është e saktë.

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

4. Kur konsiderohet i vlefshëm emetimi i aksioneve në një shoqëri aksionare:

- a) Me krijimin e shoqërisë aksionare;
- b) Me themelimin e shoqërisë aksionare;
- c) Pas regjistrimit të shoqërisë aksionare;
- d) Të gjitha alternativat së bashku.

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

5. Cilat nga alternativat më poshtë nuk zbatohet për likuiduesit e një shoqërie:

- a) Likuiduesit marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tyre;
- b) Duke qenë se likuiduesit marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, atyre u ndalohet të jenë të punësuar apo të mbajnë një pozicion drejtues në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë;
- c) Likuiduesit i nënshtrohen mbikëqyrjes së ortakëve të tjerë, asamblesë së përgjithshme, këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës;
- d) Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

6. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda:

- a) 10 ditëve nga dita e kërkit;
- b) 15 ditëve nga dita e kërkit;
- c) 30 ditëve nga dita e kërkit;
- d) Gjashtë muajve nga dita e kërkit.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

7. Në përputhje me dispozitat e ligjit për Falimentimin, nëse burimet e përftuaranga masa e pasurive të vëna përfshirë në falimentim, nuk mjaftojnë për t'i shlyer të gjithë kreditorët e një nën ndarjeje, atëherë shpërndarja ndjek parimin e:

- a) Drejtësisë shoqërore;
- b) Proporcionalitetit;
- c) Kohës së maturimit të detyrimit;
- d) Porosive të gjykatës së falimentimit.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

8. Personi i siguruar përfiton përfitimet nga sëmundja:

- a) Kur vërtetohet me raport mjekësor paaftësia për punë;
- b) Kur vuan nga një sëmundje profesionale;
- c) Kur ka pësuar një aksident në punë;
- d) Alternativat b dhe c.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

9. Në rast se subjektit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion financiar për të cilin ka dyshime se mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale:

- a) Mjafton të mos kryejë transaksionin;
- b) Nuk duhet të kryejë transaksionin dhe menjëherë raporton pranë autoritetit përgjegjës duke kërkuar udhëzime nëse duhet të kryejë transaksionin;
- c) Duhet të kryejë transaksionin në përputhje me detyrimet që ka marrë ndaj klientit të tij;
- d) Mban transaksionin pezull derisa verifikon vetë nëse qëndrojnë dyshimet e tij.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

10. Shkelja nga ana e personit juridik të detyrimeve që rëndojnë mbi të në rastin e falimentimit përbën?

- a) Vepër penale;
- b) Kundravajtje penale;
- c) Gjobë administrative;
- d) Titull ekzekutiv.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

Seksioni II

E drejta Civile- Kodi Civil dhe Kodi i Proçedurës civile

11. Cilat janë aktet që regjistrohen në Regjistrin e Pasurive të paluajtshme?

(5 pikë)

Përgjigje:

Në regjistrin e pasurive të paluajtshmeduhet të regjistrohen:

- kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre;
- kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;
- aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;
- vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit dhe fitohet pasuria e trashëguar;
- aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;
- vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbaramit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankant të tyre.

12. Në cilat raste shuhet vendosja e një sendi të paluajtshme në hipotekë?

(4 pikë)

Përgjigje:

Vendosja e një sendi të paluajtshëm në hipotekë shuhet:

- Me shuarjen e detyrimit ose me heqjen dorë të kreditorit (0.5 pikë)
- Me humbjen e sendit të lënë në hipotekë, duke respektuar të drejtat e parashikuara prej nenit 536 të këtij Kodi (1 pikë)
- Me pagimin e çmimit të shitjes me anë të ekzekutimit të detyrueshëm, kreditorëve të siguruar me hipotekë, sipas radhës së regjistrimit të tyre (1 pikë)
- Me kalimin e afatit për të cilin ishte kufizuar hipoteka (1 pikë)
- Kur shkaku i shuarjes së detyrimit deklarohet i pavlefshëm, hipoteka lind dhe regjistrohet përsëri, por regjistrimi merr numër rendor të ri. (0.5 pikë)

Seksioni III

E Drejta Tregtare edhe e Shoqërive – Kodi Tregtar

13. Cilat janë të dhënat e detyrueshme për regjistrimin e shoqërisë aksionare?

(4 pikë)

Përgjigje:

Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare (që përfshin edhe shoqëritë aksionare) janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
- f) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Gjithashtu, për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare, janë të detyrueshme edhe këto të dhëna:

- a) vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar;
- b) numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara;
- c) vlera nominale e secilit aksion;
- ç) numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner;
- d) vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksioner, si dhe pjesa e paguar prej secilit;
- dh) kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka);
- ë) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut;
- f) vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;
- g) përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike (nëse ka);
- gj) të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre;
- h) numri i anëtarëve të organeve drejtuese;
- i) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore.

Shoqëritë anonime me ofertë publike, përpara regjistrimit fillestar, duhet të regjistrojnë edhe të dhënat e identifikimit të themeluesve, projektstatutin, si dhe të kryejnë njoftimet e mëposhme, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

14. Shpjegoni mënyrat e aplikimit për regjistrim fillestar dhe të dhënat e detyrueshme për regjistrim pranë QKB përshoqëritë e thjeshta.

(3 pikë)

Përgjigje:

Shoqëritë e thjeshta rregjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, kontratën përkatëse, sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve. Në rast se palët nuk kanë lidhur kontratë me shkrim, rregjistrimi i shoqërisë sthjeshtë mund të kryhet duke depozituar vetëm aplikimin, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, kopje të dokumenteve të identifikimit dhe duke nënshkruar deklaratën e posacme për njohje, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë së thjeshtë. **(1 pikë)**

Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- b) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- c) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- d) të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
- e) vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
- f) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
- g) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve. **(2 pikë)**

15. Cilët persona ndalohet të mbajnë funksione të përfaqësuesit ligjor, anëtarë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës si dhe përfaqëruesi aksionarëve në asamblenë e përgjithshme të një shoqërie tregtare.

Shpjegoni kushtet që duhen plotësuar që një person i autorizuar për të përfaqësuar apo mbikëqyrur një shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të mund të lidhë kontrata të tjera me shoqërinë si dhe cilat janë procedurat përkatëse që duhen ndjekur.

(3 pikë)

Përgjigje:

Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimt, si dhe natyrën e objektit e interesit të tij e veprimi nuk autorizohet, paraprakisht, prej:

- a) të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie kolektive apo komandite;
- b) të gjithë ortakëve ose të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar;

- c) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e administratorëve të shoqërive aksionare;
- d) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës në shoqëritë aksionare. (0.5 pikë)

Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Miratimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. (1.5 pikë)

Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum. (0.5 pikë)

Çdo veprim që kërkon miratim, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit të personave të përfshirë. (0.5 pikë)

16. Themeluesit e një shoqërie tregtare kryejnë veprime përpara se shoqëria të regjistrohet në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit).

Përcaktoni përgjegjësitë e themeluesve para regjistrimit të shoqërisë tregtare në QKB në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë për para regjistrimit të shoqërisë në QKB. Gjithashtu, analizoni pasojat kur këta shkulin detyrat gjatë fazës së themelimit.

(4 pikë)

Përgjigje:

Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë. (1 pikë)

Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. (1 pikë)

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrejë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të nenit 10 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor brenda

90 ditëve nga marrja dijani e mospërbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. (1 pikë)

Paditë duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare. (1 pikë)

17. Një shoqëri tregtare është themeluar në shtetin X. Të gjithë veprimtarinë e administrimit e kryen në Shqipëri nëpërmjet degës së saj. Në statut, zyra qendrore përcaktohet të jetë në shtetin X.

Kërkohet të përcaktoni dhe argumentoni se në cilin vend është zyra qendrore e kësaj shoqërie dhe cilit ligj i nënshtrohet shoqëria.

(4 pikë)

Përgjigje:

Zyra qendrore e shoqërisë tregtare është vendi, ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare, nëse nuk parashikohet ndryshe në statut. Nëse në statut parashikohet zyra qendrore atëherë zyra qendrore do të jetë sipas përcaktimeve të statutit.

Personat juridik i nënshtrohen ligjit të vendit ku janë rregjistruar. Pra, shoqëria do të zbatojë ligjin për shoqëritë tregtare të vendit të origjinës dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt i dispozitave të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri lidhur me degët.

18. Sa pjesë apo përqindje e kontributit në para dhe sa pjesë apo përqindje e kontributit në natyrë duhet shlyer përpara regjistrimit të shoqërisë aksionare?

(3 pikë)

Përgjigje:

Përpara regjistrimit, aksionarët e shoqërisë aksionare të duhet të kenë shlyer të paktën $\frac{1}{4}$ e e vlerës nominale të aksioneve të nënshkruara me kontribut në para, përndryshe regjistrimi nuk mund të bëhet. Sa i takon aksioneve të nënshkruara në natyrë, ato duhet të paguhen tërësisht përpara regjistrimit. Pagimi bëhet duke kaluar titullin e pronësisë të kontributit në natyrë në favor të shoqërisë. Kontributet në natyrë duhet të vlerësohen në para përpara regjistrimit të shoqërisë dhe ky vlerësim bëhet nga një ose disa ekspertë të caktuar nga gjykata pas kërkesës së aksionarit që jep kontribut në natyrë.

19. A mund të shpërndajë dividend dega e një shoqërie aksionare të huaj? Përse?

(3 pikë)

Përgjigje:

Dega e shoqërisë së huaj, ka personalitetin juridik të shoqërisë që e ka krijuar. Rrjedhimisht, fitimet e saj konsiderohen si të shoqërisë, dhe vendimet për ndarjen e dividendit merren nga organi/et drejtuese të shoqërisë së huaj. Rrjedhimisht, dega e shoqërisë së huaj nuk mund të shpërndajë dividend, por pas zbritjes së shpenzimeve dhe ruajtjes së rezervave që mund të kërkohen nga legjislacioni shqiptar, i kalon fitimet shoqërisë së huaj që e ka krijuar.

- 20.** Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga më shumë se një person.

Në rast të tillë, si veprohet kur vota e lidhur me këtë kuotë është përcaktuese për votimin e emërimit/shkarkimit të administratorit dhe bashkëzotëruesit e saj nuk arrijnë një marrëveshje për mënyrën e votimit?

(4 pikë)

Përgjigje:

Personat që zotërojnë së bashku një kuotë të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar konsiderohen si një ortak i vetëm nga shoqëria dhe të drejtat që rrjedhin nga kuota ushtrohen bashkarisht. Në rast se bashkëzotëruesit nuk merren vesh për mënyrën e ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga kuota, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për votim në asamble, zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë. Në praktikë, kjo do të thotë se njëri nga bashkëpronarët e kuotës, duhet t'i drejtohet gjykatës kompetente për të kërkuar pjesëtimin e saj. Në varësi të vendimit të gjykatës, bëhet edhe ndarja e të drejtave (ku njërit bashkëpronar mund t'i jepet e drejta për të votuar) ose pjesëtimi i kuotës në disa kuota. Pasi vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, bashkëpronarët mund të konsiderohen ortakë të veçantë dhe të ushtrojnë veç e veç të drejtat e votës në asamble.

- 21.** A mundet administratori i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien me shoqërinë përpara mbarimit të mandatit?

(4 pikë)

Përgjigje:

Në përputhje me parashikimet e kontratës së punës, nëse ka një të tillë, apo Kodit të Punës, për aq sa ky gjen zbatim, Administratori mund të japë dorëheqje në çdo kohë, pa pritur mbarimin e mandatit. Dorëheqjen administrator ia njofton asamblesë së përgjithshme dhe gjithashtu thërret mbledhjen e saj për të emëruar administratorin e ri, duke i lënë kohë për të emëruar administratorin e ti, përpara se dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk vendos për emërimin e administratorit të ri në datën e njoftuar ëpr thirrjen e mbledhjes, administrator që kërkon të dorëhiqet ia njofton me shkrim dorëheqjen Qendër Kombëtare të Biznesit dhe kjo e fundit bën regjistrimin e dorëheqjes.

22. Cilat janë format e shoqërive aksionare dhe cili është kapitali i minimal për të regjistruar secilën prej tyre?

(3 pikë)

Përgjigje:

Shoqëritë aksionare mund të jenë shoqëri me ofertë, private apo publike, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.

Shoqëria aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë.

23. Cilat janë subjektet që kanë të drejtën të kërkojnë thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme me qëllim shfuqizimin e vendimeve të Administratorit?

(3 pikë)

Përgjigje:

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit.

Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër.

24. Shpjegoni format e obligacioneve që mund të emetojë shoqëria aksionare dhe cili është organi vendimmarrës?

(3 pikë)

Përgjigje:

Asambleja e përgjithshme mund të emetojë obligacione, që u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i konvertuar në aksione apo të drejtën e parablerjes së aksioneve, të cilat quhen obligacione të konvertueshme, si dhe obligacionet, që u japin zotëruesve të drejtën e marrjes pjesë në fitim, të cilat quhen obligacione me pjesëmarrje në fitim.

Asambleja e përgjithshme mund të autorizojë këshillin e administrimit (në sistemin me një nivel) apo administratorët (në sistemin me dy nivele), që brenda një periudhe prej 5 vitesh dhe sipas kushteve përkatëse, të emetojnë obligacionet e përmendura me sipër.

Obligacionet me pjesëmarrje në fitim mund të ofrojnë përparësi në shpërndarjen e fitimeve.

Aksionarët gëzojnë për obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim të njëjtat të drejta, që ky ligj u njeh atyre për parablerjen në rastin e emetimit të aksioneve të reja.

- 25.** Shtjelloni procedurën e regjistrimit fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja në QKB?

(3 pikë)

Përgjigje:

Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas ligjit si dhe:

- a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme; (0.6 pikë)
- b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj; (0.6 pikë)
- c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi; (0.6 pikë)
- d) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit; (0.6 pikë)
- e) vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emërtë të shoqërisë së huaj. (0.6 pikë)

- 26.** Shpjegoni mënyrat e aplikimit për regjistrim fillestar dhe të dhënat e detyrueshme për regjistrim pranë QKB për shoqëritë dhe unionet e kursim kredive.

(3 pikë)

Përgjigje:

Shoqëritë dhe unionet e kursim-kredisë, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë regjistrohen duke depozituar në regjistrin tregtar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, si dhe çdo dokument tjetër, të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi. (1 pikë)

Për regjistrimin e shoqërive dhe të unioneve të kursim-kredive, janë të detyrueshme të njoftohen:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- d) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- e) selia;
- f) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- g) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- h) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe
- i) përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit,
- j) si dhe afatet e emërimit të tyre.
- k) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë
- l) përpara të tretëve.(1 pikë)

Gjithashtu përveç të dhënave më sipër janë të detyrueshme të njoftohen edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, të dhënat e identifikimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre. (1pikë)

27. Një shoqëri aksionare është e përbërë nga 2 aksionarë. Shoqëria pas disa kohësh bëhet me një aksionar dhe aksionari i vetëm vendos të likuidojë shoqërinë. Shoqëria është në gjendjen e aftësisë pague. **(4 pikë)**

- a) Përmendni dhe shpjegoni vendimet që duhen marrë duke u bazuar në informacionin më sipër dhe procedurat që duhen kryer për këto vendime. **(3.2pikë)**

Përgjigje:

- Kur numri i aksionarëve bie në një, aksionari i vetëm duhet t'i njoftojë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit zvogëlimin e numrit të aksionarëve, si dhe emrin e tij.
 - Nëse aksionari i vetëm nuk e përmbush këtë detyrim, ai përgjigjet personalisht, në mënyrë të pakufizuar, për detyrimet që shoqëria ndërkohë ka marrë përsipër. (0.8 pikë)
- Gjithashtu duke qënë se aksionari i vetëm vendos për të likuiduar shoqërinë dhe shoqëria është në gjendjen e aftësisë pague, atëherë aksionari duhet të marrë vendimin për likuidimin e shoqërisë. (0.8 pikë)
- Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Një nga vendimet që duhet regjistruar te ky regjistër është edhe vendimi për likuidimin e shoqërisë. (0.8 pikë)

- Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. (0.8 pikë)

b) Shpjegoni caktimin e likuiduesve në rastin e shoqërive aksionare (0.8pikë)

Përgjigje:

Në shoqëritë aksionare, likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Kreditorët të cilët në keqbesim paraqesin një kërkesë për likuidimin e shoqërisë përgjigjen në përputhje me Kodin e Procedurës Civile. (0.8 pikë)

28. Në rastin e bashkimit të shoqërive, përcaktoni se cilat palë parashikohen që të mbrohen nga bashkimi dhe argumentoni përgjigjen tuaj.

(4 pikë)

Përgjigje:

Ligji parashikon që përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim duhet të kenë parasysh mbrojtjen e interesave dhe pasojat që do të ketë bashkimi ndaj:

- a) Punëmarrësve: pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesvetë tyre, si dhe masat e propozuara për to. (1 pikë)
- b) Mbrojtja e kreditorëve: Nëse kreditorët e një shoqërie, që merr pjesë në njëbashkim, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt marrëveshjes së bashkimit, paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre, shoqëria duhet t'ujapë garanci të mjaftueshme për kreditë e tyre. Garanci e mjaftueshme përkreditorët vlerësohet deklarata me shkrim, e dhënë nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçantë deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithëkreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit. Kreditorët e siguruar të procedurës së falimentit nuk kanë të drejtë të kërkojnë garancinë. (1 pikë)
- c) Mbrojtja e zotëruesve të të drejtave të veçanta: Shoqëria përthithëse detyrohet t'ugarantojë zotëruesve të obligacioneve të konvertueshme e të

aksioneve mepërparësi të njëjtat të drejta, që këta gëzonin në shoqërinë e përthithur. (1 pikë)

- d) Mbrojtja e ortakëve dhe aksionarëve: Kur aksionarët apo ortakët e shoqërive qëbashkohen nuk kanë dhënë pëlqimin për bashkim, atëherë këta kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksioneve apo kuotave tëzotëruara të tyre nga shoqëria që rezulton nga bashkimi, apo në rastmosmarrëveshjes, me çmimin e përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pavarur, i emëruar nga gjykata me kërkesë të këtyre aksionarëve apo ortakëve. Në mënyrë alternative, aksionarët mund të kërkojnë që shoqëria përthithëse të këmbejë aksionet e tyre me përparësi pa të drejtë vote, me aksione me të drejtë vote. Janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për kundërshtimet e palëve gjatë procesit të ekspertimit. Të drejtat e përmendura në më sipër duhet të ushtrohen brenda 60 ditëve nga data e publikimit të riorganizimit. (1 pikë)

Seksioni IV

E Drejta Penale – Kodi Penal dhe Proçedura Penale

29. Ndaj cilit person jepet detyrimisht heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike?

(4pikë)

Përgjigje:

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, jepet detyrimisht ndaj personit që ka kryer një krim, që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim, për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

Seksioni V

E Drejta e Punës (Kodi i Punës) dhe sigurimet shoqërore

30. Në zbatim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, a lejohet punësimi për personat nën moshën 18 vjeç? Nëse po, sa është kohëzgjatja e punës për punëmarrësit nën moshën 18 vjeç? Nëse jo, shpjegoni arsyet.

(3 pikë)

Përgjigje:

Po lejohet. Është i ndaluar punësimi për të miturit nën 16 vjeç, me disa përjashtime. Kohëzgjatja e punës për kategorinë e personave nën 18 vjeç, është jo më shumë se 6 orë në ditë.

31. Cilët janë subjektet e ligjit të sigurimeve shoqërore?

(3pikë)

Përgjigje:

Subjekte të ligjit të sigurimeve shoqërore janë personat ekonomikisht aktivë dhe personat jo ekonomikisht aktivë.

32. Ku derdhet kontributi i të vetëpunësuarve në buqësi dhe kontributet vullnetare?

(3 pikë)

Përgjigje:

Kontributet për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe kontributet vullnetare derdhen në llogarinë e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore.

Seksioni VI

Falimentimi dhe Proçedurat e tij

33. Çfarë konsiderohen shpenzime të procedurës së falimentimit dhe çfarë konsiderohen shpenzime administrative të procedurës së falimentimit?

(3pikë)

Përgjigje:

(1 pikë) Janë shpenzime të procedurës së falimentimit:

- a) shpenzimet gjyqësore;
- b) shpërblimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit, administratorit të falimentimit dhe administratorit mbikëqyrës;
- c) shpenzimet e miratuara për anëtarët të komitetit të kreditorëve.

(2 pikë) Janë shpenzime administrative të procedurës së falimentimit:

- a) shpenzimet që rrjedhin nga veprimtaritë e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës në ekzekutimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;
- b) detyrimet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes që rrjedhin pas fillimit të procedurave të falimentimit, kur debitori është individ;
- c) kreditë financiare ose tregtare që i janë dhënë debitorit me kërkesë të debitorit, me pëlqimin e administratorit mbikëqyrës ose me kërkesë të administratorit të falimentimit, në përputhje me këtë ligj, pasi të ketë filluar procedura e falimentimit;
- d) shumat që detyrohet debitori përmes kontratave të dyanshme që janë kryer ose miratuar nga administratori i falimentimit ose dministratori mbikëqyrës pas fillimit të procedurës së falimentimit;

- e) detyrimet që rrjedhin pas fillimit të procedurës së falimentimit, si rrjedhojë e pasurimit të padrejtë;

34. Cilat janë rastet kur gjykata e falimentimit vendos përkufizimin e lëvizjes së debitorit, kufizimi kuptuar si ndalimi i largimit nga vendbanimi, ose nga selia?

(3 pikë)

Përgjigje:

2. Pas marrjes në pyetje, gjykata e falimentimit mund t'i kërkojë debitorit të jetë i pranishëm dhe të mos largohet nga vendbanimi ose selia në rastet kur:

(1 pikë)

a) debitori, përfshirë drejtorët, zyrtarët, anëtarët ose aksionarët kontrollues të një shoqërie, për të cilën procedura e falimentimit ka filluar, nuk pranon të japë informacion ose deklaratë të shkruar ose të ndihmojë në përmbushjen e detyrimeve të administratorit të falimentimit;

(1 pikë)

b) debitori tenton të shmangë ekzekutimin e detyrimeve të tij për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar, në veçanti, duke përgatitur largimin e tij jashtë territorit të Shqipërisë; ose

(1 pikë)

c) kufizimi i lëvizjes është i nevojshëm për të shmangur veprimet e debitorit që janë në kundërshtim me ekzekutimin e detyrimeve të tij për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar dhe, në veçanti, të sigurojë pasurinë e përfshirë në procedurën e falimentimit

35. Kur ndodh kundërshtimi me sukses i një transaksioni të kryer përpara çeljes së procedurave të falimentimit, shtrohet pyetja lidhur me pasojat që ky kundërshtim sjell për palët e treta që kanë fituar të drejta në vijim të këtij transaksioni.

Si e rregullon ligji çështjen e palëve të treta, që i kanë fituar këto të drejta në mirëbesim? Po kur të drejtat janë fituar në keqbesim?

(3 pikë)

Përgjigje:

Nëse pasuritë ose të drejtat, objekt i veprimeve të shmangura, tashmë janë transferuar te një palë e tretë që është blerës në mirëbesim, gjykata e falimentimit urdhëron palën e tretë të dorëzojë, në masën e falimentimit, vlerën e pasurisë ose të drejtën në kohën e kryerjes së veprimit, së bashku me interesat. **(1 pikë)**

Në rast veprimi me keqbesim, kjo palë është përgjegjëse për të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj masës së falimentimit. **(0.5 pikë)**

E drejta e palës së tretë për të rimarrë përsëri atë që dorëzoi, konsiderohet si pretendim kundër procedurave të falimentimit, përveçse kur ka vepruar me keqbesim.(1 pikë) Në këtë rast, pretendimi do të konsiderohet si fundor. **(0.5 pikë)**

Seksioni VII

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi ne terrorizëm

36. Shpjegoni çfarë përfshin procedura *njihe klientin tënd*, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin të terrorizmit” (i ndryshuar).

(4pikë)

Përgjigje:

Procedura *njihe klientin tënd*” nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga institucionet financiare, që kanë të bëjnë me politikat e pranimi e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre.

SUKSESE!

Klodian Mene

Kryetar
Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale (KPAP)